



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3309/5 prot.

Datë 05.12.2025

V E N D I M

Nr. 1803/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-59279-08-27-2025, me objekt “*Blerje materiale elektrike për ndriçim në rrugët e territorit të Bashkisë Divjakë*” me fond limit 16,666,614 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

Ankimues: Operatori Ekonomik “VASAA” SHPK, me NUIS J62903470T, me adresë L. Kryengritja e Fierit, Tirane..

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Divjakë,
Lagjia nr.2, Divjakë

Subjekte të Interesuar: Operatori Ekonomik “Murati D” SHPK, me NUIS K42003004T dhe adresë: Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1- kateshe, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.08.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-59279-08-27-2025, me objekt “Blerje materiale elektrike për ndriçim në rrugët e territorit të Bashkisë Divjakë” me fond limit 16,666,614 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

II.2. Në datën 27.10.2025, autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave dhe operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht për kualifikimin dhe skualifikimin e ofertuesve, pjesëmarrësnë procedurën e mësipërme të prokurimit, si më poshtë vijon:

- | | |
|-------------------|------------------------------|
| 1. MURATI D Shpk, | 8,575,336 lekë, kualifikuar |
| 2. VASAA Shpk, | 11,239,743 lekë, kualifikuar |

3. Z D R A V A Shpk,	11,485,500 lekë, kualifikuar
4. ERVIN LUZI P.F,	11,488,550 lekë, kualifikuar
5. 2AS INVEST Shpk,	11,512,145 lekë, kualifikuar
6. ITE GROUP Shpk,	11,736,666 lekë, kualifikuar
7. ARTEO 2018 SHPK,	12,499,970 lekë, kualifikuar
8. PREKA Shpk,	12,508,730 lekë, kualifikuar
9. HEST Shpk,	13,647,105 lekë, kualifikuar
10. M U R A T I Shpk,	15,780,864 lekë, kualifikuar
11. KALIA Shpk,	14,000,000 lekë, kualifikuar
12. SARK Shpk,	14,240,600 lekë, kualifikuar
13. Bajro Bros Shpk,	0 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 11.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit.

II.4. Në datën 18.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6091 dhe nr. 3309/2025 protokoli, datë 18.11.2025 e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK.

II.5. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3309/1 prot., datë 18.11.2025, me pretendimet e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK lidhur me ofertën e paraqitur nga shoqëria “Murati D” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.3309 prot., datë 18.11.2025.

Konkretisht në ankesë pretendohet se operatori ekonomik “Murati D” SHPK ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët, të pajustificuar.

II.6. Në datën 26.11.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3309/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr.12087/1 prot., datë 26.11.2025, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, drejtuar operatorit ekonomik “VASAA” SHPK. Referuar kësaj shkrese rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Murati D” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor me nr.12087/1 prot., datë 26.11.2025, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, drejtuar operatorit ekonomik “VASAA” SHPK., protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3309/2., datë 26.11.2025, rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët

ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-59279-08-27-2025, me objekt “Blerje materiale elektrike për ndriçim në rrugët e territorit të Bashkisë Divjakë” me fond limit 16,666,614 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “VASSA” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-59279-08-27-2025, me objekt “Blerje materiale elektrike për ndriçim në rrugët e territorit të Bashkisë Divjakë” me fond limit 16,666,614 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “VASSA” SHPK .
4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

